



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Termovision" Sh.P.K. të datës 09.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "107 Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në IEA dhe nevoja tjera komunale" me nr. të prokurimit 616-25-1168-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Termovision" Sh.P.K. të datës 09.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "107 Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në IEA dhe nevoja tjera komunale" me nr. të prokurimit 616-25-1168-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Termovision shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 09.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "107 Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në IEA dhe nevoja tjera komunale" me nr. të prokurimit 616-25-1168-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi 1:

1. Certifikatat ISO

- Në momentin e ofertimit, certifikatat e ISO standardeve të paraqitura nga anëtari i Grupit tonë kanë qenë plotësisht valide dhe me afat të vlefshmërisë mbi 3 muaj. Data e dorëzimit të dosjes së tenderit 24.04.2025, ndërsa validiteti i certifikatave deri me 12.07.2025.
- Pas skadimit, certifikatat janë rinovuar nga OE përkatës, mirëpo Autoriteti Kontraktues nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të kërkuar versionet e rinovuara, gjë që përbën shkelje të nenit 72 të LPP-së, që e obligon AK-në të kërkojë sqarime dhe dokumente plotësuese përpara se të shpallë një OE si të papërgjegjshëm.

Pretendimi 2:

1. Vlerësimi i riskut

- AK ka deklaruar se vlerësimi i riskut është dorëzuar vetëm për një anëtar dhe jo për liderin, duke e përdorur këtë si bazë për eliminim.
- Ky vlerësim është në kundërshtim me nenin 69 par. 8, nenin 71 par. 4 të LPP-së, të cilat parashohin se kapacitetet teknike dhe profesionale mund të plotësohen nga secili anëtar i grupit ose edhe në mënyrë të kombinuar.

Pretendimi 3:

- Sipas nenit 26.8 të Rregullores 002/2024, AK është i obliguar që në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të specifikojë qartë se cilat kriteret duhet të përmbushen nga lideri dhe cilat mund të plotësohen nga cilido anëtar i grupit.
- Në këtë procedurë, një specifikim i tillë nuk është bërë, duke e bërë të pabazuar vendimin për eliminimin tonë.

Pretendimi 4:

1. Shkeljet e përgjithshme ligjore

Me veprimet e saj, AK ka cenuar parimet themelore të Ligjit të Prokurimit Publik, duke shkelur dispozitat ligjore:

- **Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi: par 1:** *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.”*
- AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me parimet themelore të LPP-së, sepse në vlerësimin e ofertave në këtë Aktivitet të Prokurimit nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabarët dhe jo diskriminuese OE, nuk ka vepruar në mënyrë transparente, sepse edhe përkundër se në momentin e dorëzimit të Ofertave Certifikatat e ISO kanë qenë valide, AK në mënyrë të kundërligjshme ka vlerësuar se certifikatat e ISO kanë skaduar, duke mos e respektuar Nenin 72 të LPP-së për të kërkuar nga OE dorëzimin e Certifikatave të renovuara.
- Poashtu vlen të theksohet se kjo procedurë e prokurimit është stërzgatur, duke tejkaluar të gjitha afatet Ligjore, prandaj është e natyrshme që Certifikatat do të skadojnë, sepse vlefshmëria e tyre është vetëm për një periudhë të caktuar 1 vjeçare.

Nenin 69 të LPP-së: AK nuk ka sqaruar në Dosje të tenderit se cilat nga kriteret janë obligative për të gjitha OE në rast të Grupit të OE, dhe cilat prej kriterëve mund të plotësohen vetëm nga njëri prej OE të grupit.

Kjo është e rregulluar me LPP-në Neni 69 paragrafi 8 i ligjit, si dhe Rregullorën e Prokurimit Publik rregullorja 001/2022 e plotësuar me 002/2024

- **Nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës:** edhe pse Grupi i OE “Termovision” SH.P.K. dhe “Infra Plus” SH.P.K. ka ofertuar me çmimin më të lirë, poashtu edhe me ofertën teknike të përgjegjshme, kjo vërtetohet sepse AK herën e parë e ka shpallur fitues Grupin tonë të OE, mirëpo më vonë AK në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, e ka shpallur të papërgjegjshme Ofertën tonë dhe ka shpërblyer me kontratë OE i cili ka ofertuar me çmimin më të lartë.

Pretendimi 5:

1. Mospërputhja procedurale

- Vlen të theksohet fakti se në vendimin e parë AK ka shpallur fitues Grupin e OE OE “Termovision” SH.P.K. dhe “Infra Plus” SH.P.K., ndërsa pa asnjë arsye të bazuar ligjorisht, në rivlerësimin e dytë ka ndryshuar qëndrimin dhe na ka eliminuar, duke mos kërkuar informata shtesë për pretendimet të cilat i ka ngritur në vendimin me të cilin jemi shpallur të papërgjegjshëm.
- Kjo krijon dyshim për paqëndrueshmëri dhe mungesë transparence në procesin e vlerësimit.

Sipas njoftimit mbi vendimin e AK, parashtruesi është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftojmë se oferta juaj është vlerësuar si e papërgjegjshme, për këto arsye:

Operatori ekonomik është eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: 1. Certifikatë ISO I ka me afat të skaduar, 2. Vlerësimi i riskut është dorezuar vetëm për anëtarin jo dhe për linderin.

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të parashtruesit është gjetur se arsyet eliminuese të evidentuara nga komisioni vlerësues janë të sakta. Po ashtu është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.09.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.